

## Vendim nr. 180 datë 18.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 18.09.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 21 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** SHOQËRIA “ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT ARB” SH.P.K., përfaqësuar nga administratori, Alban Ruli.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 443, datë 09.05.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti juridik efektiv për të kundërshtuar vendimin nr. 443, datë 09.05.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Konstatimi i statusit të “viktimit” përgjatë procesit gjyqësor si pasojë direkte e shkeljes kushtetuese për përfaqësim ligjor.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmtimi ka ardhur, vijon të vijë dhe do të vijojë të vijë për shkak të vendimit nr. 443, datë 09.05.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

**Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar  
(ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 15.08.2022 në gjykatën e shkallës së parë është regjistruar çështja civile me anë të së cilës pala paditëse ka kërkuar deklarin e shuarjes së detyrimit në bazë të titullit ekzekutiv të kundërshtuar, si dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Kërkesja, fillimisht ka qenë në pozitën procedurale të palës së paditur, por për shkak të ndryshimit të objektit të padisë (është hequr kërkimi për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore), ka ndryshuar dhe pozita procedurale e saj në person të tretë. Rezulton, gjithashtu, se kërkesja ka bërë kërkesë për të vijuar të përfaqësohet me avokat edhe pas ndryshimit të pozitës procedurale, kërkesë që është refuzuar nga ajo gjykatë. Për këtë shkak kërkesja i është drejtuar gjykatës me kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit të çështjes A.D., i cili ka vijuar me shqyrtimin e themelit të çështjes dhe e ka shtyrë shpalljen e vendimit përfundimtar në pritje të vendimit të asaj gjykate lidhur me kërkesën për përjashtim.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (gjyqtari i caktuar) ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit A.D. dhe me vendimin nr. akti 443, datë 09.05.2024 (*vendimi nr. 443/2024*), ka vendosur të rrëzojë kërkesën e kërkuës dhe të lejojë ankimin ndaj atij vendimi së bashku me vendimin përfundimtar në gjykatën e apelit.

3. Në datën 27.06.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

4. Ndërkohë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari A.D., pasi është informuar për mospranimin e kërkesës për përjashtim, ka shpallur vendimin përfundimtar nr. 3314, datë 29.05.2024. Me anë të tij, ajo gjykatë ka vendosur të pranojë padinë dhe të deklarojë të shuar detyrimin e treguar në titullin ekzekutiv, për shkak të ekzekutimit të tij nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (sot Ministria e Financave).

5. Në vijim të shpalljes së vendimit përfundimtar të gjykatës për themelin e çështjes, në datën 05.07.2024 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me informacion shtesë të

emërtuar “Memo – Argumente shtesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese“, ku, ndër të tjera, ka bashkëlidhur edhe kopje të atij vendimi. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuases

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se prej vendimeve të kundërshtuara i është cenuar:

6.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e përfaqësimit ligjor*, pasi nuk mund të mohohet e drejta për përfaqësim me avokat vetëm për shkak të ndryshimit të pozitës procedurale, nga palë e paditur në person të tretë. Për më tepër, kërkuases nuk i është vënë në dispozicion një vendim i ndërmjetëm për refuzimin e përfaqësimit me avokat dhe, për pasojë, ajo është vënë në kushtet që ka kërkuar përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit, pa pasur një akt për të kundërshtuar.

6.1.2. *Së drejtës për t’u njoftuar*, pasi gjykata e shkallës së parë e ka shpallur vendimin për themelin e çështjes pa njoftuar paraprakisht kërkuases dhe në përmbajtje të atij vendimi nuk ka përcaktuar adresën e saj, gjë që pamundëson komunikimet me gjykatën. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk ia ka njoftuar kërkuases vendimin nr. 443/2024 dhe as vendimin për themelin e çështjes, e cila ka marrë dijeni pasi përfaqësuesi i saj është paraqitur personalisht pranë sekretarisë së gjykatës për t’u informuar.

6.1.3. *Së drejtës për t’u gjykuar publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme* të lidhur me *parimin e sigurisë juridike*, pasi ajo gjykatë, me vendimin nr. 443/2024, ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit A.D., ndërkohë që kërkuësja priste një rezultat të njëjtë me vendimet e cituara prej saj në atë kërkesë.

6.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimi për themelin e çështjes është një vendim i njëanshëm, i varur, i ndikuar, i paragjykuar, në shkelje flagrante të drejtave procedurale dhe kushtetuese. Ndërsa vendimi nr. 443/2024 është i

paqartë në pjesën se cili do të duhet ta konsiderojë nevojën e përfaqësimit me avokat, pasi nëse kjo do të ishte në vlerësimin e gjykatës që ka gjykuar çështjen, do të ishte në shkelje të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës. Në të nuk janë konsideruar dhe pasqyruar gjetjet, referimet faktike dhe ligjore të referuara nga kërkuesja, si procesverbalet e seancës së datave 12 prill dhe 16 prill, dhe vendimet e Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

6.2. *Eliminimi i statusit të viktimës dhe dhënia e një dëmshpërblimi të arsyeshëm*, në përputhje me nenin 44 të Kushtetutës dhe nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të KEDNJ-së, më së paku sipas çështjeve *Olivieri dhe të tjerë k. Italisë, si dhe Verrascina dhe të tjerë k. Italisë* të GJEDNJ-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka marrë pjesë në proceset gjyqësore të kundërshtuara, respektivisht në cilësinë e kërkueses dhe të personit të tretë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin

përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion *subsidiar*, ai mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, duke pasur parasysh natyrën e kontrollit kushtetues individual dhe në varësi të rrethanave konkrete të çështjes rast pas rasti, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ky përjashtim zbatohet vetëm nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se procesi gjyqësor për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, në kuadër të të cilit është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar, nuk paraqet masën e duhur të autonomisë nga procesi i themelit, por është në raport ndërvarësie me të, pasi procedura e përjashtimit të gjyqtarit është në funksion të procesit të themelit. Kjo procedurë përbën një mjet juridik që garanton të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si një prej aspekteve të procesit të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit gjyqësor, në funksion të rezultatit përfundimtar. Në këtë kuptim, Kolegji thekson se pretendimet që lidhen me shqyrtimin e kërkesës për përjashtim nuk mund të ngrihen në gjykimin kushtetues si pretendime të veçanta, të shkëputura nga procesi i themelit. Si përfundim, Kolegji vlerëson se vendimi për pranimin ose jo të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes nuk është përfundimtar për efekt të gjyqimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të

Kushtetutës, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Si i tillë, ai nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë, e cila kontrollon në shkallë të fundit kushtetutshmërinë e akteve, të cilat janë përfundimtare dhe që sjellin pasoja negative për individin.

12. Kolegji vëren, gjithashtu, se në argumentet shtesë drejtuar Gjykatës, kërkesja ka kundërshtuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka zgjidhur çështjen në themel, edhe pse formalisht nuk e ka përfshirë atë në objektin e kërkesës. Lidhur me këtë, vlen të theksohet se vendimi i kundërshtuar është i gjykatës së shkallës së parë, i cili parashikon mundësinë e ankimit në gjykatën e apelit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk ka pasur asnjë pengesë që ndaj vendimit të ushtrojë mjetin e ankimit në gjykatën e apelit, përmes të cilit të ngrëjë çdo pretendim në lidhje me procesin e kundërshtuar, përfshirë edhe aspektet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt, në drejtim të standardit të paanshmërisë në atë gjykim. Vetëm pasi të ketë një përgjigje përfundimtare në lidhje me këto pretendime nga gjykatat e zakonshme, kërkesja mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkesja nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës në lidhje me këto pretendime, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Analiza e mëtejshme e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual të kërkueses bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.